



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

Data \_\_. \_\_. 2022

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“BLERJE MATERIALE INERTE”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Materiale ndërtimi dhe produkte ndihmëse për ndërtimin 44000000-0

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

---

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujesjelles Kanalizime Durres sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare 2019,2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vleres se fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Në përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Seksionit III, Neni 43 pika 2, gërma (b).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, të certifikuara nga tatimet për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatat

**EN – ISO 9001:2015** - (Per Sistemin e Menaxhimit te Cilesis).

**ISO 14001:2015** – (Standard per sistemin e menaxhimit te mjedisit).

**PAS-99;2012** – (Per Sistemin e menaxhimit te integruar ).

Shenim: Certifikatat te jene leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim. Certifikatat kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Certifikatat te jene ne gjuhen shqipe ose te noterizuara dhe duhet të jenë në proporcion me objektin e kontratës.

Argument:

Kjo kerkese eshte vendosur bazuar ne nenin 79/1 te ligjit nr. 162/2020, Per prokurimin publik, e cila ka lidhje teknike me objektin qe prokurohet dhe eshte proporcionale me objektin e kontrates.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të kete ne pronesi ose te paraqes një kontrate noteriale furnizimi, kontrate qeraje, per inertet dhe betonin: lejen e ndërtimit dhe autorizim mjedisor (leje) për aktivitetin: Impiant prodhim betoni (QKL Kodi: III.1.B).

Per Inertet  
Betonin

2.3.4 Afati i kontrates se furnizimit te mbuloje të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur bazuar ne nenin 77/1/C dhe 77/4 te ligjit nr. 162/2020, Per prokurimin publik, e cila ka lidhje teknike me objektin qe prokurohet dhe eshte proporcionale me objektin e kontrates. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Kjo kerkese gjithashtu eshte vendosur bazuar dhe ne nenin 79/1 te ligjit nr. 162/2020, Per prokurimin publik, e cila ka lidhje teknike me objektin qe prokurohet dhe eshte proporcionale me objektin e kontrates.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin e mallit të kërkuar në objekt, pranë Autoritetit kontraktor, brenda afateve, sasitë dhe specifikimeve të përcaktuara të sasia dhe grafiku i lëvrimit.

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, dhe në mbështetje të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu, kjo kërkohet për të siguruar Autoritetin Kontraktor që operatori ekonomik i shpallur fitues do të relizojë me mjetet e veta transportin, montimin e mallrave objekt prokurimi brenda afateve të përcaktuara në dokumentatat e tenderit.

2.3.6 Ofertuesi për mallrat objekt prokurimi (**Asfalt i ftohte, Llac me ngrirje të shpejte 24 Mpa për 24 ore, Llac me fibra celiku me ngrirje të avashte, Llac me fibra xhami me rezistence të larte  $\geq 60$  Mpa**) duhet të dorëzojë Autorizim Prodhuesi, ose distributori. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik ta vertetojë këtë duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marreveshje lidhur me Kompanisë prodhuese ose Distributorit të autorizuar. Gjithashtu për këto produkte Ofertuesi duhet të paraqesë dokumenta teknike si: katalog apo frangmente katalogu dhe skemat teknike të këtyre produkteve objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në këtë procedurë, garanton Autoritetin Kontraktor se Ofertuesi është i autorizuar për ofrimin e këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Kjo kërkesë është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e Operatorit Ekonomik ofertues për aftësitë teknike dhe njëkohësisht i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e mundësisë së OE ofertues për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.7 Ofertuesi për mallrat objekt prokurimi (**Asfalt i ftohte, Llac me ngrirje të shpejte 24 Mpa për 24 ore, Llac me fibra celiku me ngrirje të avashte, Llac me fibra xhami me rezistence të larte  $\geq 60$  Mpa**) duhet të paraqesë certifikatat ISO të prodhuesit:

**EN – ISO 9001:2015** - (Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë).

**ISO 14001:2015** – (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit).

## Certifikaten e ekselences.

Shenim: Çertifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79(Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor), të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40 dhe nenin 44(Kërkesat e cilësisë) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të kësaj kërkesë, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë kualifikimet/ certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën. Përmbushja e standardit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së mallrave që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për mallrat e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë.

### **2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të disponojë makinerite e meposhtme :**

Lloji i makinerive	Sasia	Pronesia
<b>Kamion vetshkarkues</b>	<b>Cope 3</b>	<b>Ne pronesi ose me qera</b>
<b>Kamioncine vetshkarkuese 3.5-7.5 ton</b>	<b>Cope 1</b>	<b>Ne pronesi ose me qera</b>
<b>Fadrome me goma</b>	<b>Cope 1</b>	<b>Ne pronesi ose me qera</b>
<b>Autobetoniere</b>	<b>Cope 2</b>	<b>Ne pronesi ose me qera</b>
<b>Eskavator me goma</b>	<b>Cope 1</b>	<b>Ne pronesi ose me qera</b>
<b>Autopompe betoni</b>	<b>Cope 1</b>	<b>Ne pronesi ose me qera</b>

**Makinerite dhe pajisjet duhet të jene ne pronesi ose me qera të cilët ti vërtetojë me leje qarkullimi, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,foto.Për mjetet e siguruar me qera të paraqesë dokumentin që vërteton regjistrimin e tij, çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, leja e transportit nga Bashkia apo Komuna për vete ose të tretë dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.**

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.Gjithashtu ky kriter e siguron autoritetin kontraktor duke i dhënë garanci që i gjithë malli objekt prokurimi do të transportohet në mënyrë të sigurt për në ambientet e Autoritetit Kontraktor.Te gjitha mjetet e

kerkuara kane lidhje teknike me zerat e preventivit si dhe jane te domosdoshme per permbushjen me sukses te kontrates.

### **2.3.9 Afati i levrimit te mallit do jete 300 dite kalendarike sipas kerkeses se ndermarrjes.**

**Argument:** Kjo kerkese eshte hartuar bazuar ne legjislacionin e prokurimit publik, ku ofertuesi duhet te jape oferten ne procedure qe konkuron, pjese e se ciles eshte preventive edhe grafiku i levrimit, pjese e dokumenteve standarte te tenderit. Gjithashtu grafiku i levrimit eshte nje kerkese e cila garanton Autoritetin/Entin Kontraktor qe ofertuesit duhet te kene parasysh ne afatin e realizimit te kontrates dhe sipas periudhave kohore perkatese

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Tabela përmbledhëse e pajisjeve:**

<b>NR</b>	<b>EMËRTIMI</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIMI</b>
<b>1</b>	Tulla te plota	copë	2800	70
<b>2</b>	Bllloqe betoni 25 x 25 x20 cm	copë	50	80
<b>3</b>	Rere e lare	m <sup>3</sup>	350	2,050
<b>4</b>	Çimento	kv	500	2000
<b>5</b>	Çakell	m <sup>3</sup>	300	2,200
<b>6</b>	Hekur ø 12 per kapake betoni	kg	200	250
<b>7</b>	Hekur ø 16 per punime zgarash	kg	300	250
<b>8</b>	Hekur ø 20 per punime zgarash	kg	200	250
<b>9</b>	Profil L 50 x 50 x 2.5 mm	kg	150	250
<b>10</b>	Rere ose shtufe per mbulim kanali	m <sup>3</sup>	100	1200
<b>11</b>	Gelqere	kg	150	25
<b>12</b>	Boje Antirruzhe	kg	10	2000
<b>13</b>	Granil	m <sup>3</sup>	100	1850
<b>14</b>	Profil L 80 x 80 x 5 mm	kg	50	150
<b>15</b>	Tel 6 per zhbllokim	kg	300	200
<b>16</b>	Tel Bari	kg	50	200
<b>17</b>	Gozhde ø 8 mm	kg	50	200
<b>18</b>	Gozhde ø 10 mm	kg	50	200
<b>19</b>	Gozhde ø 12 mm	kg	50	200
<b>20</b>	Zhavorr lumi I lare	m <sup>3</sup>	50	1100
<b>21</b>	Zgare ø 10mm (10 m2)	copë	100	1,600
<b>22</b>	Beton M-250	m <sup>3</sup>	20	10500
<b>23</b>	Stabilizant	m <sup>3</sup>	80	1400



<b>24</b>	Derrase per armature	m <sup>3</sup>	5	48,000
<b>25</b>	Betoforma per armature	m <sup>3</sup>	10	48,000
<b>26</b>	Asfalt I ftohte	kg	200	600
<b>27</b>	Llac me ngrirje te shpejte 24 Mpa per 1 ore	kg	120	4000
<b>28</b>	Llac me fibra celiku me ngrirje te avashte	kg	120	3500
<b>29</b>	Llac me fibra xhami me rezistence te larte 60 Mpa	kg	120	3000
<b>30</b>	Pllaka vetshternguese	M <sup>2</sup>	200	600